

VENDIM
Nr.354, datë 4.5.2011

PËR SHPRONËSIMIN SHITESË PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR LEVAN - VLORË (SEKSIONI I DYTË)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin shtesë, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Levan - Vlorë (seksioni i dytë).

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet sipas listës bashkëlidhur, për objekte me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 11 728 903 (njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e tre) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 11 728 903 (njëmbëdhjetë milionë e shtatëqind e njëzet e tetë mijë e nëntëqind e tre) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

5. Shpronësimi të fillojë më 1.5.2011 dhe të përfundojë më 1.9.2011.

6. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmohet nga ZVRPP-ja”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

7. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmohet nga ZVRPP-ja”, brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi, si dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

8. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

9. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

10. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
LISTA E OBJEKTEVE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT LEVAN-VLORË
Lloji i pasurisë së paluajtshme: Objekte

Nr.	Pronari			Vendndodhja	Z.K.	Nr.pas.	Vlera totale lekë	Lloji i objektit	Shënime
	Emri		Mbiemri						
1	Astrit, Arjan		Spaho	Pus Mezin	8605	67/1-ND1; 67/1-ND2	6 201 538	Karburant	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
2	Astrit, Arjan		Spaho	Pus Mezin	8605	67/1-ND1; 67/1-ND3	3 323 560	Investim	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
3	Hysni		Bulla	Bishan	1191	21/63	2 203 805	Shtëpi banimi	Konfirmuar nga ZVRPP-ja
		Totali					11 728 903		